

Prof. Dr. Muharrem DEZHGIU

**PROBLEME DHE REZULTATE TË ARSIMIT SHQIP
NË “TOKAT E LIRUARA” (1941-1944)***

Pas pushtimit të Jugosllavisë, në prill të vitit 1941, nga italo-gjermanët, mjaft qendra urbane me rrethinat e tyre, deri në atë kohë në Maqedoni, u përfshinë në zonën italiane të pushtimit, njëherazi të bashkuara me Shqipërinë, në kuadër të një administrate të përbashkët. Pikërisht ato territore, që pas pushtimit të Jugosllavisë iu bashkuan Shqipërisë, u njohën me emërtimin “tokat e liruara”. Shqipërisë iu bashkuan: 19 prefektura, 13 bashki, 141 komuna, 1 501 katunde, me një popullsi 840 852 banorë.¹

Në raport me gjendjen e mëparshme politike, shoqërore dhe ekonomike, nën sundimin sllav, popullsia e këtyre viseve e përjetoj situatën e re, pas bashkimit, si një çlirim të saj. Ndërsa, një pjesë e propagandës e konsideronte këtë situatë të re zëvendësim të një pushtuesi me një tjetër.

Interesat e shumicës së popullsisë së trevave shqiptare në Maqedoni, të përfshira në zonën e pushtimit italian, dhe të bashkuara me Shqipërinë, ishin në fokusin e propagandës fashiste. Kjo e fundit e trumbetoi me të madhe çlirimin e shqiptarëve dhe krijimin e “Shqipërisë së Madhe” për interesat e veta.

Duhet njohur tashmë si fakt historik, që zona e pushtimit italian, ndonëse nën skeptrin e pushtuesit, ishte, objektivisht, mishërim i ëndrës së shqiptarëve për Shqipërinë e vërtetë. Shumë treva shqiptare, të ndara më parë, u bashkuan, siç thuhej, me vendin amë.

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor të organizuar nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Strugë 11 nëntor 2006.

¹ *Arkivi Qendror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 267, viti 1941, dos.46, fl.32.

Në shtratin e kësaj situatë të përgjithshme politike, pushtuesi italian përpunoi një politikë të caktuar arsimore ndaj kësaj popullsie. Qëllimi i saj ishte zhvillimi arsimor i kësaj popullsie në gjuhën amtare, që, sipas pushtuesit, kjo popullsi, të integrohej sa më shpejt në “Shqipërinë e Madhe”, si pjesë e perandorisë fashiste. Ndryshe nga ky synim i pushtuesit, shqiptarët e shfrytëzuan këtë situatë, për të realizuar bashkimin shpirtëror e social të të gjithë shqiptarëve, e për t’u bërë ballë, të bashkuar, armiqve të huaj, kushdo që të ishin ata. Ndaj, në ato vite, shpërtheu një entuziazëm i pashembullt e i gjithanshëm i organeve të arsimit, i mësuesve, nxënësve dhe kursistëve, për të fituar kohën e humbur. Lipsej të kapërcehej prapambetja e thellë arsimore e kulturore e popullsisë shqiptare, të cilën e kishte lënë në këtë gjendje regjimi i mëparshëm jugosllav.

Një revistë e kohës vinte në dukje se, si të gjitha qendrat e tjera, edhe “Struga e ndjeu peshën e rëndë të lënies mbas dore prej shumë kohe...”.¹

Politika diskriminuese e ish-Jugosllavisë për shkollimin e përparimin e shqiptarëve vihej në dukje në mjaft dokumente. Nga ana tjetër, krijoheshin privilegje për popullsinë sllave. “Në një numër të madh katundesh me banuesa krejt shqiptarë, thuhej në një dokument, nuk ka pas fare shkolla, kurse në katundin Bervecicë, i formuar me malazez, të sjellë në tokat shqiptare, u ka ndërtue një shkollë madhështore”¹. Në Liceun e Tetovës, megjithëse ishin 450 nxënës në vit, në kohën e Jugosllavisë, vetëm 3 shqiptarë kanë dalë nga kjo shkollë.²

Rrethanat e krijuara për zhvillimin masiv dhe me shpejtësi të arsimit shqip, edhe në kohë të vështira të luftës botërore, u vlerësuan tepër të rëndësishme jo vetëm në aspektin iluminist, por edhe në aspektin patriotik, kombëtar. Kështu, Inspektoria Arsimore e Tetovës kishte përcaktuar hapjen e 70 shkollave³ gjatë vitit 1943, për arsimimin e popullsisë në gjuhën shqipe. Rëndësinë e kësaj detyre e konfirmonte shtypi arsimor i kohës. Revista “Shkolla Shqiptare” theksonte: “Ata që shkojnë në kurse e dijnë dhe e çmojnë se gjuha asht tapia e vendit dhe shpirti i kombit... Kemi me shkue dhe na pleqt në shkollë e jo ma fëmijët tanë. Na kena xânë gjuhën e shkjahut e si mos me xânë tonën?”⁴. Mësuesit që erdhën nga Shqipëria e punuan në këto vise, morën përsipër një mision tepër të rëndësishëm atdhetar, për ta ndriçuar shqiptarin e këtushëm, të mbuluar nga një natë “shpirtërore e plotë”, sepse, “duke u

¹ *AQSh*, Fondi 295, viti 1942, dos.119, fl.24.

² *Po aty*, fl.25.

³ *Po aty*, fl.24.

⁴ “Shkolla shqiptare”, viti 1942, nr.52, f.12.

mundue me mësue një gjuhë të huaj për 4 vjet, nuk fitonte asgjë nga shkolla”.¹

Politika arsimore shqiptare, e ndjekur në këto vise, gjatë viteve 1941-1943, synonte: Nga njëra anë, të njihej dhe të inkurajohej “de jure” zhvillimi i arsimit dhe i shkollës shqipe. Ndonëse ky synim bëhej për konsum propagandistik, nga pushtuesi i huaj, i hapte rrugë iniciativës dhe ndjenjave arsimdashëse të shqiptarëve, i inkurajonte ata për të vepruar vetë. Në proces e sipër nuk u tregua gatishmëria e duhur nga autoritetet e huaja për realizimin në praktikë të kësaj politike. Madje, u krijuan edhe vështirësi, të cilat u kapërcyen, në fund të fundit, nga vetë shqiptarët, si nga organet e arsimit, ashtu edhe nga populli.

Një ndër vështirësitë, që krijonte vetë pushtuesi, ishte zënia e lokaleve shkollore ekzistuese, për nevojat e ushtrisë së tij, duke i detyruar mësuesit ta zhvillonin mësimin në shtëpi private e në kushte të papërshtatshme. “Në Strugë, vihej në dukje në një raport të kohës, shkolla ishte instaluar në një godinë private në të cilën më parë ka qenë zyra e Financës, godinë kjo fare e papërshtatshme për arsim dhe tepër e vogël ... kurse godinat shkollore që janë pasuri arsimore dhe shumë të përshtatshme janë okupuar prej ushtrisë, e cila i përdor si depo”.² Në Dibër është zënë godina shkollore, e cila përdorej si mence ushtarake.³ Ndërsa, në po të njëjtin dokument, mësojmë se, “në afërsi të shkollës fillore të Gostivarit ushtria ka bamë një shtallë kuajsh tue okupue dhe një pjesë të oborrit të shkollës”.⁴

Mungesa e lokaleve shkollore e shtrëngonte drejtorinë e Shkollës fillore të Strugës të lajmëronte Ministrinë e Arsimit se, “nuk mund të marrë masa për zbatimin e detyrimit shkollor”.⁵

Nëpunësit e administratës, që shkonin nga Shqipëria në “zonat e liruar”, merrnin grada më të larta, për rrjedhojë edhe pagesa e tyre rritej. Ky trajtim u bëhej atyre për t’i nxitur të kryenin detyrën. Një gjë e tillë kërkohet edhe për mësuesit, të cilët shërbenin me aq vetëmohim.⁶ Gjendja ekonomike e arsimtarëve ishte kaq e rëndë sa një pjesë e mirë e tyre nuk ishin në gjendje “as me pague mjetin e transportit që i kishte sjellë në këto anë”.⁷ Megjithatë, siç vinte në dukje Inspektoria e Tetovës,

¹ Artikulli i Qemal Haxhihasanit në: “Shkolla shqiptare”, viti 1942, nr.56, f.154.

² *AQSh*, Fondi 295, viti 1942, dos.119, fl.15.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*

⁵ *Po aty*, dos.227, fl.19, datë 3 mars 1942.

⁶ *Po aty*.

⁷ *Po aty*, dos.119, fl.24. Relacion i Inspektorisë së Arsimit të Tetovës dërguar Inspektorit Epror të Kryesisë KM.

“personeli arsimor meritonte mirënjohjen e kombit për vullnetin e mirë, zellin dhe aftësinë e shqueme që ka tregue në mësimin e tij”.¹

Etja e popullit për dije në gjuhën shqipe bëhej nxitje për organet e arsimit, që të vlerësonin drejt këto vështirësi. Këto vështirësi e nxitën administratën vendëse të merrte vetë iniciativa për të zgjidhur problemet. Kështu, Bashkia e Tetovës dhe komuna e qendrës së Gostivarit u jepnin mësuesve të qyteteve të tyre si subvencion nga 40 Fr. shq. në muaj si ndihmë. Ndërsa, Dibra, Kërçova dhe Struga nuk mund ta bënin një gjë të tillë. Megjithatë, organet lokale të arsimit kërkonin nga Ministria e P. të Brendshme të urdhëronte këto komuna që të vepronin njësoj si Tetova e Gostivari.² Këtyre komunave nuk u mungonte vullneti që ta bënin një gjë të tillë me urdhër, por u mungonte buxheti.

Promemorjet dhe kërkesat e drejtuesve të shkollave, drejtuar organeve epore për nevojat dhe për rregullimin e gjendjes së shkollave, janë të konsiderueshme. Zv/drejtori i Shkollës bujqësore të Tetovës, Sami Hysi, e motivonte kërkesën për ndërhyrje të shtetit në shkollën e tij, për ta bërë atë “një fole drite për bujqit e fushës së Tetovës në pikëpamje teknike dhe një vatër ku mund të zhvillohej një shqiptarizëm e shëndetshme dhe solide ndër zemrat e të rinjve të Tetovës”.³ Kësaj promemorjeje shqetësuese të drejtorisë së Shkollës bujqësore të Tetovës dikasteri qendror do t’i jepte një përgjigje cinike, duke kërkuar “një preventiv shkoqitës të nënvizuar me bojë të kuqe për të nxjerrë fondet për këtë shpenzim”!⁴ Qëndrimet e tilla të institucioneve qendrore të superstrukturës politike është pak të quhen propagandistike. Në këto rrethana, përsëri iu mbetesh mësuesve iniciativa të vepronin me kurajo e guxim për të kapërcyer këto vështirësi. Me të drejtë, organet e shtypit e krahasonin punën e mësuesit në “tokat e liruara” me atë të mjekut kirurg “që, pasi të bëjë ekzaminimin e gjendjes, vepron si një operator i guximshëm me thikën e mprehtë të zanatit të tij”.⁵

Për zhvillimin e mësimit në gjuhën shqipe ishte problem më vete edhe sigurimi i kuadrit. Ai u përgatit me cilësitë e mjaftueshme në rrethanat e kohës. Kujdes i veçantë u bë për të mënjnauar kuadrot e huaja,⁶ që flisnin jo shqip, si dhe për të kontrolluar rolin e shkollave fetare, ku jepnin mësim hoxhallarë të papërgatitur. Duke parë të metat e disa hoxhallarëve në shkollat fetare, si “krejt në kundërshtim me kombëtarizmin, dhe që merr në qafë kaq fëmijë me metodat dhe me

¹ *Po aty*, fl.14.

² *Po aty*, fl.16.

³ *Po aty*, fl.22.

⁴ *Po aty*, fl.23.

⁵ “Shkolla shqiptare”, nr.56, f.153.

⁶ *AQSh*, Fondi 295, viti 1942, dos. 227, fl.20.

mësimet (të ashtuquajtura) që zhvillojnë”, prefekti i Dibrës, Sami Koka, propozonte të mbylleshin pa vonesë këto shkolla.¹

Ministri i Arsimit, ndonëse e merrte parasysht këtë dobësi të shkollave fetare, për kombëtarizimin e tyre porosiste për mënyra të tërthorta dhe takt që, me propagandë kombëtare, t’u tërhiqen fëmijët këtyre shkollave (është fjala për shkollat fetare-M.D.) dhe të shkonin për të ndjekur rregullisht shkollat shtetërore.²

Nga sa parashtroam mund të arrihet në përfundimin se, rrethanat politike të krijuara në vitet 1941-1944 dhe masat në fushën arsimore, i dhanë mundësinë popullsisë shqiptare në “tokat e liruara” të çlirohej nga shtypja e mëparshme shkombëtarizuese ndaj saj. U krijuan kushte objektive në fushën e arsimit për të vepruar në interes të luftës dhe të çlirimit kombëtar.

Politika e pushtuesit, ndonëse për interesa propagandistike, u shfrytëzua maksimalisht, nga shqiptarët, për të arritur rezultate në lëmin e arsimit shqip, edhe në kushtet e luftës. Rezultatet e arritura në fushën e arsimit shqip në këto vite përbëjnë një etapë tepër të rëndësishme në përpjekjet e shqiptarëve në mbrojtje të identitetit kombëtar.

¹ *Po aty*, fl.13.

² *Po aty*, fl.14. Qarkore e Ministrisë së Arsimit, nr.893, datë 29.11.1942.

